



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina

KRYETARI I KRYEQYTETIT

Në bazë të dispozitave të nenit 13 të Ligjit nr. 03/L - 040 për Vetëqeverisje Lokale dhe nenit 53 të Statutit të Komunës së Prishtinës 01. nr. 110 - 391, të dt. 25.02.2010, Kryetari i Kryeqytetit merr këtë:

V E N D I M

1. Themelohet Komisioni për vlerësimin e ofertave për dhënie me qira të vendgjuetive të përbashkëta në Komunën e Prishtinës.
2. Komisionin nga pika 1 e këtij Vendimi, e përbëjnë:
 - 2.1. Agim Cukaj, Drejtorja për Zhvillim Rural;
 - 2.2. Miradije Gashi Qorolli, Drejtorja për Zhvillim Rural;
 - 2.3. Albina Qestaj, Sektori Ligjor.
3. Detyrat dhe punët e komisionit të cekur në pikën 2 të këtij vendimi, janë vlerësimi i ofertave dhe përzgjedhja e subjekteve fizike apo juridike duke u bazuar në ftesën publike për dhënie në menaxhim me qira të vendgjuetive të përbashkëta, "Prishtina I" dhe "Prishtina II" në territorin e Komunës së Prishtinës, si dhe Ligjin nr. 02/L- 053 për Gjuetinë dhe akteve tjera nën ligjore në fuqi.
4. Për kryerjen e detyrave si në pikën 3 të këtij vendimi, komisioni i raporton Kryetarit të Kryeqytetit.
5. Ky vendim hynë në fuqi në ditën e nënshkrimit të tij.

I DORËZOHET:

- Anëtarëve të komisionit;
- Qendrës për shërbim me qytetar;
- Në dosje.

KRYETARI I KRYEQYTETIT
Përparim Rama

